



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 66, datë 08.04.2020

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.24. DATË 10.02.2020, “MBI PROCEDURËN E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREG TË PARREGULLUAR NGA FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË FTL SH.A

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 53, pika 3 të ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë Teknike në lidhje me një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr.24. datë 10.02.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga furnizuesi i tregut të lirë FTL sh.a,

Konstatoi se:

- Me vendimin nr.24 date 10.02.2020, Bordi I ERE vendosi:
 - Për një periudhë tranzitore deri në miratimin e rregullave të tregtimit të Energjisë elektrike, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të Energjisë elektrike të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a” të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

- Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. të propozojë për miratim në ERE brënda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Rregullat për tregtimin e energjisë elektrike të mbështetur në parimet e barazisë dhe të transparencës.
- Në datë 10.03.2020, me shkresën nr. 633.1 prot, protokolluar në ERE në datë 30.03.2020, shoqëria FTL sh.a. i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për shtryjen e afateve të përcaktuara në këtë dispozitë
- FTL sh.a. bën me dije se, për shkak të rëndësisë që ky dokument ka, punës së bërë në drejtim të përshtatjes së Rregullores së tregëtimit të energjisë elektrike me Rregulloren e shitblerjes së energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.103/2016, masave të marra për shkak të përhapjes së epidemisë së Covid 19, kufizimit të aktiviteteve dhe veprimtarive private e shtetërore në Shqipëri, e ka të pamundur respektimin e afateve të vendosura në vendimin e bordit të ERE nr. 24/20200, për hartimin dhe propozimin për miratim në ERE të Rregullave për tregëtimitin e energjisë elektrike.
- Aktualisht në vend është shpallur gjendja e epidemisë për shkak të Covid 19, Këshilli i Ministrave ka miratuar disa akte normative mbi masat për parandalimin e Virusit Covid 19 duke përcaktuar ndër të tjera edhe kufizim në qarkullimin e njerëzve por edhe kufizim të disa aktiviteteve gjatë gjendjes së virusit Covid 19.
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 është vendosur për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
- Në nenin 53, pika 3 të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet se: Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.
- Kërkesa e FTL sh.a. është e ligjshme dhe është depozituar në ERE brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi

1. Në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr.24. datë 10.02.2020, “Mbi procedurën e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në treg të parregulluar nga furnizuesi i tregut të lirë FTL sh.a, bëhet ndryshimi si më poshtë:
 - a. FTL sh.a. të propozojë për miratim në ERE brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të fuqisë juridike të akteve ligjore të Qeverisë Shqipëtare për

mbrojtjen nga epidemia Covid 19, Rregulloren e tregëtimit të energjisë elektrike, të mbështetur në parimet e barazise dhe të transparencës.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI